

# Trajtimi institucional i rasteve të dhunës në familje

KORRIK 2022 - QERSHOR 2023

Korrik 2023



Grupi për Studime  
Juridike dhe  
Politike



# Trajtimi institucional i rasteve të dhunës në familje

KORRIK 2022 - QERSHOR 2023

## Autor:

JUST REACT - Rritja e Reagimit  
Qytetarë për një Qasje të  
Përmirësuar në Drejtësi në Kosovë

## Kontributorët:

Dea Feti, Dinore Xhemajli,  
Elza Tullari, Erëblina Polloshka,  
Jetlira Sallteku, Liridon Salihi,  
Renata Bajrami dhe  
Valentina Shahini-Grajçevci

Korrik 2023

Projekti "JUST REACT - Rritja e  
Reagimit Qytetarë për një Qasje të  
Përmirësuar në Drejtësi në Kosovë"  
financohet nga Bashkimi Evropian  
dhe zbatohet nga Grupi për Studime  
Juridike dhe Politike (GLPS) në  
bashkëpunim me Fondin për  
Zhvillimin e Komunitetit (CDF)

\* Ky publikim është përgatitur  
me mbështetjen financiare të  
Bashkimit Evropian.  
Përmbajtja e tij është  
përgjegjësi ekskluzive e  
Grupit për Studime Juridike  
dhe Politike (GLPS) dhe  
Fondit për Zhvillimin e  
Komunitetit (CDF) dhe nuk  
pasqyron domosdoshmërisht  
pikëpamjet e Bashkimit  
Evropian.'



# Pasqyra e Përmbajtjes

Hyrje.....	04
Metodologjia.....	05
Korniza ligjore aktuale për mbrojtje nga dhuna në familje në Kosovë	06
Raportimi në Policinë e Kosovës i rasteve të dhunës në familje.....	08
Numri i rasteve të raportuara sipas rajonit.....	08
Marrëdhënia familjare ndërmjet viktimave dhe të dyshuarve për dhunë në familje .....	10
Grupmoshat e të dyshuarve dhe viktimave të dhunës në familje.....	11
Trajtimi i rasteve të dhunës në familje nga Prokurori i Shtetit.....	12
Matjet e performancës së Prokurorit të Shtetit në rastet e dhunës në familje.....	12
Aktakuzat në rastet e dhunës në familje.....	14
Gjetjet nga analiza e 30 aktakuzave për raste të dhunës në familje.....	14
» Veprimet inkriminuese dhe arsyetimi i tyre.....	15
» Cilësimi juridik i veprës penale.....	15
» Propozimi i rrethanave lehtësuese dhe rënduese.....	16
Trajtimi i rasteve të dhunës në familje nga gjykatat e shkallës së parë.....	17
Rastet e dhunës në familje të trajtuara nga gjykatat e shkallës së parë shprehur në numra.....	17
Gjetjet kryesore nga aktgjykimet e analizuara.....	18
» Efikasiteti dhe përputhshmëria me dispozitat ligjore për publikimin e aktgjykimeve.....	18
» Politika e ndëshkimit/dënimit në rastet e dhunës në familje.....	20
» Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë.....	21
Urdhrat për mbrojtje kundrejt kërkesave kundër dhunës në familje.....	22
Të dhënat nga monitorimi i seancave gjyqësore.....	23
Gjetjet dhe rekomandimet.....	24

## Hyrje

Dhuna në familje është një problem shoqëror i cili nuk njihet kufij, dhe prek të gjitha kulturat dhe shoqëritë anembanë botës, përfshirë k Kosovën. Kjo sfidë globale paraqet një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut, duke kërcënuar zhvillimin shoqëror dhe paqen. Statistikat tregojnë se, në mbarë botën, një në tre gra përballet me dhunë seksuale ose fizike gjatë jetës së tyre.<sup>1</sup>

Për më tepër, sipas një ankete të zhvilluar në vitin 2019 nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë, 54% e grave të anketuara kanë përjetuar dhunë psikologjike, fizike apo seksuale, nga një partner intim, pas moshës 15 vjeçare.<sup>2</sup> Një anketë tjetër e kryer nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) në vitin 2015, zbuloi se 68% e grave dhe 57% e burrave kishin qenë viktimë e dhunës në familje të paktën një herë në jetën e tyre.<sup>3</sup> Si e tillë, dhuna në familje është një shkelje e përhapur e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, që bie ndesh me një numër alarmues të popullsisë.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), me mbështetjen e Bashkimit Evropian, zhvillon projektin “JUST REACT”, përmes të cilit monitoron në baza të rregullta funksionimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, duke u përqendruar kryesisht në analizën sesi i trajtojnë institucionet ligjzbatuese rastet e dhunës në familje. Në kuadër të këtij projekti, GLPS ka publikuar këtë analizë periodike, e cila trajton reagimin institucional ndaj dhunës në familje, brenda një periudhe njëvjeçare (nga 1 korriku 2022 deri më 30 qershor 2023).

Objektivi i këtij raporti është të paraqesë dhe analizojë të dhënat nga disa prej institucioneve kyçe të cilat merren me dhunën në familje: policia, prokuroria dhe gjykatat, në tre kapituj përkatës.

Në kapitullin e parë, raporti shqyrton të dhënat nga Policia e Kosovës, duke u përqendruar në grupmoshat dhe gjinitë e të prekurve nga dhuna në familje. Ai gjithashtu analizon shpërndarjen rajonale të rasteve të raportuara dhe marrëdhëniet familjare ndërmjet kryerësve dhe viktimave.

Kapitulli i dytë e zhvendos fokusin tek Prokurorinë e Shtetit të Kosovës, ku vlerëson performancën e saj dhe bën një analizë të aktakuzave të cilat kanë të bëjnë me dhunën në familje.

Së fundi, kapitulli i tretë përqendrohet në trajtimin e rasteve të dhunës në familje nga ana e gjykatave, duke ofruar gjetjet kryesore të paraqitura në formë numerike dhe sipas shpërndarjes rajonale. Raporti gjithashtu ofron një analizë të aktgjykimeve të përzgjedhura për rastet e dhunës në familje, duke vlerësuar përputhshmërinë e tyre me ligjin. Përveç kësaj, ai heton lëshimin e urdhrave për mbrojtjes nga gjykatat dhe paraqet të dhëna nga seancat gjyqësore të cilat janë monitoruar.

1 “Dhuna me bazë gjinore”, UNHCR, e qasshme në:

<https://www.unhcr.org/what-we-do/protect-human-rights/protection/gender-based-violence>

2 “Anketa për mirëqenien dhe sigurinë e grave në Kosovë”, OSCE 2019, e

qasshme në: <https://www.osce.org/files/f/documents/e/4/439790.pdf>

3 “Mjaft më me arsyttime: Një analizë e qëndrimeve, incidencës dhe përgjigjes institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë”, RrGK 2015, e qasshme në:

<https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20151124105025622.pdf>

## Metodologjia

Të dhënat për këtë raport janë marrë nga dy burime kryesore: të dhënat zyrtare nga institucionet kyçe të përfshira në trajtimin e rasteve të dhunës në familje, përkatësisht Policia e Kosovës, Prokuroria e Shtetit të Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, dhe të dhënat e mbledhura përmes monitorimit të kryer nga ekipi i **JUST REACT**. Informacionet u mbledhën dhe u analizuan për **periudhën nga korriku i vitit 2022 deri në qershor të vitit 2023**.

Pjesa fillestare e të dhënave të shfrytëzuara në këtë raport është mbledhur nga burime zyrtare brenda sistemit të drejtësisë së Kosovës. Këto të dhëna përfshijnë statistika lidhur me raportet, aktakuzat dhe rastet e gjykuara në lidhje me rastet e dhunës në familje. Analiza e këtyre të dhënave u përqendrua në faktorët demografikë dhe, kur ishte e aplikueshme, në përputhje me standardet ligjore. Të dhënat zyrtare nga Policia e Kosovës, Prokuroria e Shtetit të Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës përfshinin statistika lidhur me numrin e raporteve mbi dhunën në familje, aktakuzat e nxjerra dhe rastet të cilat iu nënshtruan shqyrtimit gjyqësor. Ky informacion u shqyrtua për të vlerësuar tendencat dhe modelet **përgjatë kornizës kohore të specifikuar**.

Së bashku me të dhënat zyrtare, ekipi i JUST REACT zhvilloi aktivitete monitoruese për të arritur perceptcion shtesë lidhur me trajtimin e rasteve të dhunës në familje në Kosovë. Procesi i monitorimit përfshiu analizën e 30 aktakuzave të marra nga prokuroria dhe 129 aktgjykimeve të publikuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Për të vlerësuar cilësinë e aktakuzave, mostra prej 30 lëndëve nga prokuroria është shqyrtuar me kujdes për të konstatuar shkallën e pajtueshmërisë me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPPK). 129 vendime të publikuara në ueb faqen e Këshillit Gjyqësor u analizuan për të përcaktuar shpërndarjen e aktgjykimeve, përfshirë aktgjykimet fajësuese, të lirimit dhe refuzimet. Gjithashtu, vëmendje e veçantë iu kushtua politikave ndëshkuese/dënuese të ndjekura nga gjykatat përkatëse në dënimin e kryerësve të dhunës në familje, me fokus në dënimet e shqiptuara. Në fund **u analizuan 72** raste të urdhrave për mbrojtje për viktimat e dhunës në familje.

Një aspekt tjetër i procesit të monitorimit ishte vëzhgimi i seancave gjyqësore lidhur me rastet e dhunës në familje. Ekipi ruajti me kujdes konfidencialitetin e këtyre procedurave gjatë mbledhjes së të dhënave thelbësore. Kjo metodë i mundësoi ekipit të arrinte një perceptcion të drejtpërdrejtë mbi dinamikën e sallës së gjyqit dhe mënyrën në të cilën rastet u trajtuan.

## Korniza ligjore aktuale për mbrojtje nga rastet e dhunës në familje në Kosovë

Për sa i përket dokumenteve ligjore, Kosova është e përkushtuar që të adresojë dhunën në familje dhe të sigurojë të drejtat themelore të të gjithë individëve në territorin e saj. Ky zotim fillimisht është i mishëruar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila kapitullin e dytë ia kushton **mbrojtjes së të drejtave të njeriut**.

Së dyti, në vitin 2020, Kosova miratoi një amendament Kushtetues, për t'i dhënë zbatim të drejtpërdrejtë Konventës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje, e njohur si Konventa e Stambollit. Kjo Konventë është një traktat historik për të drejtat e njeriut të Këshillit të Evropës, e cila ofron udhëzime për krijimin e një kornize ligjor për të mbrojtur gratë nga të gjitha format e dhunës, dhe për të parandaluar dhe ndjekur penalisht dhunën kundër grave dhe dhunën në familje. Në këtë Konventë, dhuna kundër grave përkufizohet si “shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënimet për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private”.<sup>5</sup>

Së treti, Kodi Penal i Kosovës (KPRK), e identifikon dhunën në familje si vepër penale të veçantë në kuadër të nenit 248 të tij. Ky nen parashikon se “Kushdo që e kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një në marrëdhënieje familjare dënohet me gjobë dhe me **burgim deri në tre (3) vjet**”.

Së katërti, përveç KPRK-së, një dokument tjetër i rëndësishëm ligjor është Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (LMDhF).<sup>6</sup> LMDhF, e përkufizon dhunën në familje si një ose më shumë vepra ose lëshime të qëllimshme që i bën një person kundër një personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare, si këto, por nuk kufizohet në: përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes; çdo veprim tjetër të një anëtari të familjes që mund të shkaktojë apo kanos, se do të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike; shkaktimin e ndjenjën së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit; dhe sulmin fizik pa marrë parasysh pasojat. Për më tepër, dhuna në familje nënkupton ofendimin, sharjen, thirrjen me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë; përsëritjen e vazhdueshme të sjelljeve me qëllim të përluljes së personit tjetër; marrëdhënien seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimin seksual; kufizimin e kundërligjshëm të lirisë së lëvizjes së personit tjetër; dëmtimin apo shkatërrimin e pasurisë dhe kanosjen për ta bërë këtë; vënien e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale ose ekonomike; hyrjen me forcë ose largimin me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesa e personit tjetër; dhe rrëmbimin”.<sup>7</sup>

4 Amendamenti i Kushtetutës së Republikës së Kosovës Nr.07-V-058. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

5 “Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)”, Këshilli i Evropës, 2022, Neni 3 (a)

6 Ligji Nr.03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2691>

7 Ibid

Për më tepër, LMDhF trajton mirëqenien e të mbijetuarve brenda familjeve, thekson trajtimin për kryerësit dhe kërkon të trajtojë pasojat më të gjera të dhunës në familje. Ligji gjithashtu u jep gjykatave themelore autoritetin për të shqyrtuar dhe lëshuar urdhra për mbrojtje, të cilat përpiqen të mbrojnë në mënyrë efektive të mbijetuarat/it nga ekspozimi ndaj dhunës, duke hequr rrethanat të cilat **mund të çojnë në dëme të mëtejshme**.

Së fundi, Kosova gjithashtu ka hartuar edhe Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, për periudhën 2022-2026.<sup>8</sup> Kjo strategji përmban veprime dhe masa të cilat synojnë të avancojnë mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna kundër grave në përputhje me standardet e instrumenteve të ratifikuara ndërkombëtare.



8 Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026, e qasshme në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/ALB-Strategjia-Kombëtare-për-Mbrojtje-nga-Dhuna-në-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022---2026.pdf>


# Raportimi në Policinë e Kosovës i rasteve të dhunës në familje

Policia e Kosovës (PK) mbetet institucioni më i besueshëm për qytetarët për sa i përket raportimit të kriminalitetit,<sup>9</sup> he është institucioni i parë i cili trajton rastet e dhunës në familje. Ky kapitull paraqet një analizë të të dhënave kyçe që kanë të bëjnë me dhunën në familje në Kosovë në lidhje me rastet që janë raportuar në PK në periudhën e caktuar të monitorimit. Kapitulli është i ndarë në seksione të veçanta, ku secili prej tyre fokusohet në aspekte të veçanta të dhunës në familje, duke përfshirë shpërndarjen gjeografike të rasteve të raportuara, dinamikën gjinore, marrëdhëniet familjare ndërmjet të dyshuarve dhe viktimave dhe grupmoshat e atyre që janë përfshirë.

## Numri i rasteve të raportuara sipas rajonit

Sipas të dhënave zyrtare të siguruara nga PK-ja, gjatë periudhës së vlerësimit (korrik 2022-qershor 2023), janë raportuar gjithsej 2735 raste të dhunës në familje në nivel vendi. Për sa i përket kësaj çështjeje, Prishtina prinë për nga numri i rasteve të raportuara, me gjithsej 910 raste, ose mbi 1/3 e totalit të rasteve të raportuara në mbarë vendin.

**Grafiku 1.** Raportimi në Policinë e Kosovës i rasteve të dhunës në familje në periudhën 1 korrik 2022- 30 qershor 2023



<sup>9</sup> Indeksi i Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit - RoLPIK - Botimi i 8-të, Mars 2023, linku: <https://shorturl.at/abES4>



Prishtina ndiqet nga Peja, Prizreni, Gjilani, Ferizaji dhe Gjakova. Në anën tjetër, dhuna në familje është më pak e raportuar në rajonin e Mitrovicës, në përgjithësi, me 230 raste, përderisa Mitrovica e Jugut, është vendi me numrin më të ulët të rasteve të raportuara të dhunës në familje, me 87 raste.

Për të ofruar një pikëpamje rajonale në lidhje me rastet e raportuara, të dhënat janë analizuar gjithashtu duke marrë parasysh edhe popullsinë e secilit rajon. Kjo për faktin se Prishtina natyrshëm del si rajoni me numrin më të madh të rasteve të raportuara sepse ka një popullsi më të madhe. Sidoqoftë, vlerësimi duke marrë si pikë referimi popullsinë në rajone jep një pasqyrë më të qartë se cilat rajone kanë nivelin më të lartë të rasteve të dhunës në familje në raport me popullsinë e tyre.

Për qëllimet e kësaj analize është përdorur pika e referimit prej 10,000 banorësh dhe ajo bazohet në numrin zyrtar të popullsisë të raportuar nga Regjistrimi i fundit zyrtar i popullsisë i kryer në vitin.<sup>10</sup> Kur merret parasysh standardi i popullsisë Peja rezulton të jetë rajoni me numrin më të madh të rasteve të raportuara të dhunës në familje për 10,000 banorë, me 27 raste të raportuara për çdo 10,000 banorë, e ndjekur nga Prishtina me 23 raste.<sup>11</sup>

Për sa i përket rajoneve tjera, të dhënat sugjerojnë se numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara gjatë periudhës korrik 2022 - qershor 2023, për 10,000 banorë është si vijon: Gjakova dhe Ferizaj me 15 raste secili, Gjilani me 13 raste, Prizreni me 11 raste dhe **rajoni i Mitrovicës me 8 raste.**

## Aspekti gjinor i rasteve të raportuara të dhunës në familje

Nga 2,735 raste të raportuara, 2,165 ishin gra ndërsa 559 ishin burra viktimat të dhunës në familje.

N% këtë kapitull, fokusi zhvendoset në dinamikën gjinore të dhunës në familje, duke shqyrtuar se si ajo prek në mënyrë disproporcionale gratë në krahasim me burrat. Kjo pabarazi gjinore është një fakt i vërtetuar, që mbështetet nga marrëveshjet ndërkombëtare si Konventa e Stambollit, e cila njih se gratë dhe vajzat janë të ekspozuara ndaj një rreziku të dhunës me bazë gjinore dukshëm më të lartë sesa burrat.<sup>12</sup> Të dhënat e paraqitura në këtë kapitull nënvizojnë më tej këtë

çështje duke treguar se në Kosovë, sipas raportimeve të policisë në shumicën e rasteve, gratë janë viktimat kryesore të dhunës në familje.

Sipas të dhënave të PK-së, 79% (ose 2165 individë) e viktimave ishin femra, ndërsa meshkujt përbëjnë 21% (ose 559 individë) të viktimave.


<sup>10</sup> Regjistrimi i Popullsisë në Kosovë 2012, I qasshëm në:

[https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata/Census%20population/Census%202011\\_3%20By%20Municipalities/census32.px/table/tableViewLayout1/](https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata/Census%20population/Census%202011_3%20By%20Municipalities/census32.px/table/tableViewLayout1/)

<sup>11</sup> Numri nxirret duke pjesëtuar numrin e rasteve të raportuara (338) me numrin e popullsisë (123.614) dhe më pas duke shumëzuar atë me 10.000, ku rezulton se janë raportuar afërsisht 27 raste të kësaj natyre në 10.000 banorë.

<sup>12</sup> "Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)", Këshilli i Evropës, 2022, Preambula.

**Grafiku 2.** Raporti gjinor ndërmjet të dyshuarve, personave të arrestuar dhe viktimave të dhunës në familje gjatë periudhës korrik 2022-qershor 2023



Për më tepër, të dhënat sugjerojnë se nga 2735 raste të raportuara, 2735 persona janë arrestuar për dhunë në familje, nga të cilët mbi 80% (ose 2186) janë meshkuj, ndërsa rreth 20% (ose 549) janë femra. Kur themi këtë, në çdo pesë persona të arrestuar për ushtrim të dhunës në familje, katër prej tyre janë burra dhe një është grua. Ngjashëm, burrat kryesojnë gjithashtu edhe në numra për sa i përket të dyshuarve për dhunë në familje.

Më tej, numri i personave të arrestuar, në lidhje me rastet e raportuara, është rritur krahasuar me një raport të mëparshëm të JUST REACT për periudhën janar-gusht 2022.<sup>13</sup> Në lidhje me këtë, vihet re një tendencë mjaft pozitive sa i përket numrit të personave të arrestuar për dhunë në familje. Në vitin aktual nga 2735 raste të raportuara në PK janë arrestuar 2735 persona. Kjo përbën ndryshim me periudhën e fundit të monitoruar (janar-gusht 2022), siç është raportuar nga një raport i mëhershëm i JUSTREACT, kur në PK ishin raportuar 1852 raste dhe ishin arrestuar vetëm 682 persona.


## Marrëdhënia familjare ndërmjet viktimave dhe të dyshuarve për dhunë në familje

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i adresuar në këtë raport është marrëdhënia familjare ndërmjet të dyshuarve dhe viktimave të dhunës në familje. Gjatë analizimit të të dhënave të PK-së, vërehet se në shumicën e rasteve dhuna ka ndodhur në marrëdhënien bashkëshortore. Më pastaj, rastet që përfshijnë prindërit të cilët ushtrojnë dhunë ndaj fëmijëve të tyre dhe anasjelltas, janë të zakonshme. Për dallim nga kjo, rastet e dhunës në familje në marrëdhëniet ndërmjet vëllezërve dhe motrave janë më të rralla.

Mbi 80% e kryerësve të arrestuar për dhunë në familje janë meshkuj, ndërsa rreth 20% e tyre janë femra. Nga kjo statistikë rezulton se nga çdo pesë persona të arrestuar për ushtrim të dhunës në familje, katër prej tyre janë burra dhe një është grua.

13 Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Analiza “Raportimi dhe trajtimi i rasteve të dhunës në familje, në periudhën janar-gusht 2022”, Tetor 2022, link: <https://shorturl.at/ipAM9>

**Grafiku 3.** Numri i rasteve sipas raportit ndërmjet të dyshuarit dhe viktimës së dhunës në familje




## Grupmoshat e të dyshuarve dhe viktimave të dhunës në familje

Për sa i përket grupmoshave, të dhënat tregojnë se nga 2573 persona të dyshuar për ushtrimin e dhunës në familje, 783 (apo 30%) i përkasin grupmoshës 30-40 vjeç, 635 (apo 25%), nga të dyshuarit i përkasin grupmoshës 20 -30 vjeç, dhe 565 (apo 22%) e të dyshuarve i përkasin grupmoshës nga 40 deri në 50 vjeç.

Të dhënat për grupmoshat e viktimave sugjerojnë se dominon grupmosha 20-30 vjeç me 653 raste, apo 36%, e ndjekur nga grupmosha 30-40 vjeç me 622 raste, apo 35%, dhe grupmosha 40-50 vjeç me 526 raste, apo 29%.

**Grafiku 4.** Grupmoshat më të prekura nga dhuna në familje në periudhën korrik 2022-qershor 2023



Andaj, duke marrë parasysh zhvillimin bio-psikik, rrethanat sociale dhe kulturore, situatën ekonomike dhe faktorët e tjerë, grupmoshat 20-30, 30-40 dhe 40-50 vjeç rezultojnë të jenë ndër moshat më të prekura, pa përjashtuar edhe grupmoshat e tjera të cilat gjithashtu nuk përbëjnë përjashtime.

## Trajtimi i rasteve të dhunës në familje nga Prokurori i Shtetit


Ndjekja penale efektive është thelbësore në adresimin e dhunës në familje. Ky kapitull shqyrton nga afër rolin të cilin e luan Prokurori i Shtetit në trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Me përgjegjësinë e hetimit, ngritjes së aktakuzës dhe ndjekjes penale të kryerësve të dhunës në familje, prokurorët e shtetit janë në qendër të reagimit ligjor. Ky kapitull shqyrton matjet e rasteve të dhunës në familje nga Prokurori i Shtetit, aktakuzat për rastet e dhunës në familje, merr parasysh vështirësitë e veprimeve inkriminuese dhe arsyetimin e tyre, vlerëson kualifikimet ligjore të veprave penale të dhunës në familje dhe analizon propozimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese - elementë të cilët ndikojnë në rezultatet e dënimit. Për më tepër, ai trajton çështjen e recidivizmit dhe rëndësinë e tij si një rrethanë rënduese. Në thelb të analizës së këtij kapitulli janë gjetjet e nxjerra nga analiza e 30 aktakuzave për dhunën në familje, të cilat ofrojnë njohuri për qasjen e Prokurorit të Shtetit në adresimin e kësaj çështjeje kritike.

### Matjet e performancës së Prokurorit të Shtetit në rastet e dhunës në familje

Për sa i përket performancës së këtij institucioni lidhur me trajtimin e rasteve të dhunës në familje, të dhënat nga Zyra e Statistikave të KPK-së,<sup>14</sup> sugjeron se në periudhën raportuese, Prokuroritë Themelore në nivel vendi kanë pranuar 3169 raste me 5223 të dyshuar (të rritur dhe të mitur). Në këtë periudhë, ata kanë zgjidhur 3.679 raste me 3.964 të dyshuar, që e bën Prokurorin e Shtetit 116% efikas në trajtimin e dhunës në familje.

Sa i përket të dyshuarve madhorë, Prokurori i Shtetit ka hedhur poshtë kallëzimet penale ose ka mbyllur hetimet ndaj 267 personave ose rreth 16% të të dyshuarve për dhunë në familje.

**Grafiku 5.** Rastet dhe të dyshuarit e dhunës në familje të procesuar nga Prokurori i Shtetit




14 Të dhëna të pranuar nga Zyra për Komunikim e KPK-së, 27 korrik 2023

Sidoqoftë, nga 1 korriku 2023, Prokuroria Themelore kishte ende një numër të konsiderueshëm prej 2,496 lëndësh/rastesh në proces të trashëguara nga vitet e kaluara që përfshinin 2,930 të dyshuar. Kështu që, ky efikasitet duhet të vazhdojë trendin e rritjes.

Për më tepër, të dhënat tregojnë se Prokuroritë Themelore në rastet kur të dyshuarit ishin madhorë, hodhën poshtë kallëzimet penale ose mbyllën hetimet për 267 persona, ngritën aktakuzë kundër 1498 personave, caktuan masa trajtimi të detyrueshëm për 46 persona dhe morën vendime të tjera, përfshirë masat për trajtim të detyrueshëm dhe cedimin e kompetencës, për 125 të rritur të dyshuar për ushtrim të dhunës në familje. Nga këto raste, 702 persona janë dënuar nga gjykatat përkatëse, ndërsa 26 janë liruar bazuar në vendime gjyqësore. Përveç kësaj, në 20 raste është refuzuar aktakuza dhe në 63 raste janë shqiptuar masa të trajtimit të detyrueshëm. Në një numër të vogël të rasteve gjykata ka marrë vendime në bazë të afatit të parashkrimit të ndjekjes penale, në total 3 raste.

Lidhur me rastet që përfshijnë të dyshuar të mitur, Prokurori i Shtetit raporton se 32 individëve u janë nënshtruar masave të diversitetit (masa të dizajnuara për të parandaluar, nisjen e procedurës gjyqësore kundër kryerësve të mitur, për të lehtësuar rehabilitimin pozitiv dhe riintegrimin në komunitetet e tyre për të penguar sjelljen recidiviste).<sup>15</sup> Ndaj 14 personave u morën masa të shtuara mbikëqyrjeje, ndërsa dy të tjerë u urdhëruan për trajtim. Dy raste janë zgjidhur me mjete alternative ndërsa në 19 raste është marrë vendim për fillimin e hetimeve. Në lidhje me vendimet e gjykatave në këto raste janë marrë vendime ndaj 20 personave të mitur, ku ata kanë zbatuar një masë edukative të parashikuar në Kodin e Drejtësisë për të Mitur.

**Grafiku 6.** Vendimet në lidhje me personat e dyshuar për dhunë në familje (madhorë dhe të mitur)



<sup>15</sup> Sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur, masat e diversitetit të cilat mund t'i shqiptohen të miturit janë: pajtimi ndërmjet kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë kërkimin faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar; pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij; kompensimi i dëmit palës së dëmtuar, në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet të dëmtuarit, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiare të të miturit; vijimi i rregullt në shkollë; pranimi i punësimit ose aftësisimit për një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathtësitë e tij; kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme, në pajtim me aftësinë e kryerësit të mitur për kryerjen e punës së tillë. Kjo masë mund të shqiptohet me pëlqimin e të miturit në kohëzgjatje prej dhjetë (10) deri në gjashtëdhjetë (60) orë; edukimi në rregullat e trafikut; këshillim psikologjik; angazhimi në aktivitete bamirësie; pagesa e një shume të caktuar të të hollave të destinuara për qëllime bamirësie apo në programin për kompensim të viktimave në përputhje me situatën financiare të të miturit; angazhimi në aktivitete sportive dhe rekreative; këshillimi ndërmjet familjeve të të miturve; përmbajtja nga çdo kontakt me individë të caktuar që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri; përmbajtja nga frekuentimi i vendeve ose mjediseve të caktuara që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri; dhe përmbajtja nga përdorimi i drogës dhe alkoolit; vërejtja policore.

## Aktakuzat në rastet e dhunës në familje

Sipas të dhënave të siguruara nga JUST REACT, gjatë periudhës së vlerësimit, Prokurori i Shtetit dhe Prokuroritë Themelore kanë ngritur aktakuza kundër 1498 personave. Këto akuza përfshijnë aktakuza të drejtpërdrejta, aktakuza të ngritura në vijim të hetimeve, apo vendime për lëshimin e urdhrave ndëshkues.

Duke qenë se dhuna në familje nënkupton cenimin e drejtpërdrejtë të dinjitetit të personit, korniza ligjor e cila e rregullon këtë vepër penale, përfshirë ngritjen e aktakuzës, kërkon një trajtim më të ndjeshëm. Prandaj, përveç zbatimit të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale për aktakuzat, prokurorët duhet të marrin parasysh edhe udhëzimet e Gjykatës Supreme lidhur me klasifikimin ligjor dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje sipas KPRK-së. Ky udhëzues përshkruan nenet e KPRK-së të cilët mund të zbatohen në lidhje me nenin 248 të KPRK-së, kur veprat e tjera kanë ndodhur brenda një marrëdhënieje familjare ose kanë përfshirë një viktimë të cënueshme dhe të ndjeshme ndaj veprave si kërcënimet, sulmet seksuale, lëndimet, shtrëngimi, privimi i paligjshëm nga liria, skllavëria, ngacmimi, përdhunimi, sulmi seksual dhe shkelja e integritetit seksual. Kjo qasje siguron që përgjigja ligjore ndaj dhunës në familje të përputhet me natyrën e ndjeshme të këtyre rasteve dhe siguron mbrojtje të përshtatshme për viktimat.<sup>16</sup>

## Gjetjet nga analiza e 30 aktakuzave për rastet e dhunës në familje

KPPRK në nenin 235 ka përcaktuar elementet të cilat duhet t'i përmbajë aktakuza e ngritur nga prokurori për të gjitha veprat penale, përfshirë dhunën në familje.<sup>17</sup>

Për të vlerësuar nëse prokurorët i përfshijnë të gjitha elementet e parapara në nenin 235 të KPPRK-së në aktakuzat për rastet e dhunës në familje, JUST REACT ka analizuar 30 aktakuza nga prokurorë të ndryshëm të ngritura gjatë periudhës së vlerësimit.<sup>18</sup> Një temë që dukshëm përsëritet në aktakuzat e analizuar, është prioritetizimi i rasteve të dhunës në

<sup>16</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, Udhëzimi lidhur me cilësimin juridik dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, linku: <https://shorturl.at/BLUX7>

<sup>17</sup> Neni 235 i KPPRK parasheh që aktakuza duhet të përmbajë: përcaktimin e gjykatës ku do të mbahet shqyrtimi gjyqësor; emrin dhe mbiemrin e të pandehurit dhe të dhënat e tij personale; % dhënat nëse është shqiptuar paraburgimi dhe sa kohë zgjat apo masat e urdhëruara kundër të pandehurit për të siguruar praninë e tij, nëse ai ndodhet në liri dhe nëse ai është liruar para ngritjes së aktakuzës, sa është mbajtur në paraburgim; emërtimin ligjor të veprës penale duke iu referuar dispozitave të Kodit Penal; kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, objektin mbi të cilin është kryer dhe mjetin me të cilin është kryer vepra penale; Gjithashtu, si elemente të detyrueshme të aktakuzës janë rekomandimi për provat që duhet të prezantohet në shqyrtimin gjyqësor së bashku me emrat e dëshmitarëve dhe ekspertëve, shkresat që duhen lexuar dhe sendet që duhet marrë si provë, shpjegimin e arsyeve për ngritjen e aktakuzës bazuar në rezultatet e hetimit dhe provat që vërtetojnë faktet kryesore; identitetin e palës së dëmtuar ose viktimës të njohur për prokurorin e shtetit, nëse ka ndonjë; specifikimin e pasurive që i nënshtrohen konfiskimit të njohura për prokurorin e shtetit në kohën e ngritjes së aktakuzës, përfshirë informacionin mbi poseduesin, respektivisht pronarin dhe palët e treta me interes për pasurinë si dhe arsyetimin të kërkesës për konfiskim, propozimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese të njohura në kohën e dorëzimit të aktakuzës, të cilat mund të jenë relevante për marrjen e vendimit të duhur. Përveç këtyre elementeve, nëse i pandehuri gjendet në liri, prokurori i shtetit në aktakuzë mund të propozojë që të jepet urdhri për paraburgimit, e kur i pandehuri ndodhet në paraburgim, prokurori i shtetit mund të propozojë që ai të lirohet.

<sup>18</sup> Aktakuzat e analizuar: PP/Il.nr.969-8/22; PP/Il.nr.981-11/22; PP/Il.nr.852-2/22; PP/Il.nr.1036-11/22; PP/ Il.nr.1036-11/22; PP/Il.nr.1036-11/22; PP/Il.nr.442-4/22; PP/Il.nr.500--1/22; PP/Il.nr.1005-1/22; PP/Il.nr.1310-2/22; PP/Il.nr.852-2/22; P/Il.nr.1765-11/22; PP/Il.nr.1520-11/22; PP/Il.nr.221-4/22; PP/Il.nr.237-15/22; PP/Il.nr.54-12/23; PP/Il.nr.538-5/23; PP/Il.nr.1249/22; PP/Il.nr.1280/22; PP/Il.nr.1282/22; PP/Il.nr.1122/22; PP/Il.nr.429/22; PP/ Il.nr.1506/22; PP/Il.nr.302/23; PP/Il.nr.1479/20; PP/Il.nr.92/23F; PP/Il.nr.60/23F; PP/Il.nr.5621/19; PP/Il.nr.4460/20;

familje nga ana e Prokurorit të Shtetit. Veçanërisht, Prokurori i Shtetit ka ndërmarrë veprime të shpejta duke ngritur aktakuza menjëherë pas pranimit të kallëzimeve penale. Për më tutje, një trend tjetër i vërejtur në aktakuzat e analizuara është se shumica e viktimave janë gra dhe në shumicën e rasteve dhuna në familje ka ndodhur në marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve. Kjo pasqyron analizën e të dhënave të raportimeve të policisë, të shqyrtuara në kapitullin e mëparshëm.

### › Veprimet inkriminuese dhe arsyetimi i tyre

Në kontekst të rasteve të dhunës në familje, në fazën e hetimit del në pah një sfidë, ku baza e aktakuzës mund të vihet në pikëpyetje. Shpesh, këto raste mbështeten në masë të madhe në dëshminë e viktimës si burim parësor provash, për shkak të natyrës private dhe të ndjeshme të incidenteve të tilla. Megjithatë, dispozitat ligjore, si neni 257 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK),<sup>19</sup> nënvizojnë nevojën për burime të shumta provash për të vërtetuar fajësinë e të akuzuarit. Kjo mund të krijojë një dilemë, pasi që mungesa e provave materiale shtesë shpesh rezulton nga vetë natyra e rasteve të dhunës në familje, ku dëshmitarët dhe provat e jashtme mund të jenë të pakta.

Më tej, vlen të përmendet se në rastet e monitoruara nga JUST REACT, prokurorët ndonjëherë dështojnë në ofrimin e një arsyetimi më gjithëpërfshirës për veprimet e të akuzuarit apo edhe provave materiale në rastet që janë të pranishme, në mënyrë potenciale për shkak të natyrës delikate të këtyre veprave. Si rezultat, disa aktakuzave u mungon arsyetimi i hollësishëm ligjor i veprimeve inkriminuese. Kjo më pas mund të çojë në diskutime për një shkelje të mundshme të parimit *In Dubio Pro Reo*, sipas të cilit kur ka ndonjë dyshim ose pasiguri lidhur me fajin e një personi, vendimi duhet të favorizojë të akuzuarin.

### › Cilësimi juridik i veprës penale

KPPRK e obligon Prokurorin e Shtetit që me rastin e ngritjes së aktakuzës të bëjë një përshkrim adekuat të veprës penale i cili i përgjigjet veprimeve inkriminuese. Mirëpo, në aktakuzat e analizuara, JUST REACT ka evidentuar raste të cilësimit joadekuat të veprave penale nga ana e Prokurorit të Shtetit në rastet e dhunës në familje. Në lidhje me këtë çështje, duke parë paqartësitë brenda neneve, Gjykata Supreme doli me një Udhëzim përkatës për të sqaruar dilemat lidhur me cilësimin juridik me përkufizimin ligjor dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje sipas Kodit Penal të Kosovës.<sup>20</sup>

Sipas udhëzimit, kur kemi të bëjmë me rastet e dhunës në familje, parimi parësor është që kualifikimi i veprës penale të jetë në përputhje me nenin ose nenet përkatëse të KPRK-së. Me shpjegim me të thjeshtë, kur elementet e një vepre penale ose komponentët e saj bazike plotësohen në një rast të dhunës në familje, gjykata duhet të zbatojë nenin përkatës të KPRK-së i cili i përgjigjet asaj vepre, në vend që t'i referohet ekskluzivisht nenit 248 të KPRK-së, i cili adreson në mënyrë specifike dhunën në familje.<sup>21</sup>

Megjithatë, gjatë analizës së rasteve, u vu re se për një rrethanë të ngjashme, prokurorët janë të prirur të bëjnë kualifikime të ndryshme, të cilat nuk janë përputhje me udhëzimin

PP/II.nr.268/22F;

19 Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, i qasshëm në: <https://shorturl.at/imJMQ>

20 Gjykata Supreme e Kosovës, Udhëzimi lidhur me cilësimin juridik dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Qershor 2020, i qasshëm në:

[Guidance 113/2020](#)

21 Ibid

e Gjykatës Supreme.<sup>22</sup> Në shumë raste, Prokurori i Shtetit bashkon një veprë penale kryesore me një akuzë për dhunë në familje në një aktakuzë të vetme. Kjo rezulton në dy veprime të ndryshme juridike për një veprë të vetme penale, gjë që mund të çojë në shqiptimin e dy dënimeve - njëri në bazë të veprës themelore dhe tjetri për veprën e dhunës në familje. Për më tepër, ka raste kur një veprë penale cilësohet si dhunë në familje, edhe kur plotësohen elementet dhe kriteret e veprave të tjera. Kjo ngre shqetësime rreth mundësisë për akuza dhe dënime të mbivendosura apo të tepërta.

### > Propozimi rrethanave lehtësuese dhe rënduese

Element tjetër i aktakuzës siç përcaktohet në nenin 235 të KPPRK-së është edhe obligimi i prokurorit që të propozojë rrethanat lehtësuese dhe rënduese të njohura në kohën e dorëzimit të aktakuzës. Megjithatë, shumicës së aktakuzave mostra u mungon ky **element**.

Në këtë drejtim, deri në hyrjen në fuqi të Kodit të Ri (në vitin 2022), Kodi i mëparshëm nuk kërkonte në mënyrë kategorike përfshirjen e rrethanave lehtësuese dhe rënduese në aktakuzë. Kjo risi e Kodit të ri Penal u pasua me nxjerrjen e një Udhëzuesi të veçantë, i cili specifikon rolin dhe kontributin e Prokurorit të Shtetit në përllogaritjen e dënimit ndaj të akuzuarve, nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKSh).<sup>23</sup>

Sipas këtij udhëzimi, prokurorët duhet të paraqesin rrethanat lehtësuese dhe rënduese brenda aktakuzës.

Në aktakuzat e analizuara (që nga hyrja në fuqi e KPPRK-së së re), JUST REACT ka konstatuar se në shumë raste, prokurorët nuk kanë përfshirë rrethana lehtësuese dhe rënduese ndaj personave të përfshirë në aktakuza.

Në këtë kuptim, lindin shumë sfida për sa i përket përcaktimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese. Për shembull, gjendja ekonomike e të pandehurit, që është një rrethanë lehtësuese, në shumicën e aktakuzave të analizuara bazohet vetëm në deklaratën e të pandehurit, në mungesë të bazës së duhur të të dhënave lidhur me të gjitha të dhënat personale të personave të dyshuar. Në disa raste më të rralla, është konstatuar se prokuroria ka kërkuar një vërtetim të gjendjes ekonomike të të pandehurit, siç është përcaktuar nga KPPRK-ja dhe Udhëzimi i ZKSh-së.<sup>24</sup> Një shembull tjetër i kompleksitetit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese është çështja e recidivizmit. Kjo çështje është e rregulluar me nenin 74 të KPPRK-së, i cili i jep gjykatës mundësinë që të rrisë dënimin në rast se i pandehuri është përsëritës. Në këtë kuptim, ekipi i JUST REACT zbuloi se në shumicën e rasteve prokurorët përdorin vetëm një raport të shkurtër nga Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës (SIPK) i cili përmbledh të kaluarën potencialisht kriminale të të akuzuarve. Çuditërisht, ky raport shpeshherë shtohet në shkresat e lëndës pa më shumë hollësi dhe pa elaborim ndërsa në raste të tjera as nuk përmendet fare në aktakuzë.

Trajtimi i çështjes së recidivizmit qëndron në rolin e prokurorit në llogaritjen e dënimit që do t'i shqiptohet kryerësit. Prandaj, është e padiskutueshme që prova dhe elaborimi i recidivizmit nga ana e prokurorit i ndihmon gjykatës në punën e saj efikase për zbardhjen e çështjes penale dhe marrjen e një vendimi të drejtë.

22 Ibid

23 Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Udhëzim, 2020, linku: <https://shorturl.at/APU01>

24 Udhëzim mbi rolin dhe kontributin e Prokurorit të Shtetit në matjen e dënimit: <https://shorturl.at/jwBFW>




## Trajtimi i rasteve të dhunës në familje nga gjykatat e shkallës së parë

Në këtë kapitull fokusi vihet në procesin gjyqësor brenda gjykatave të shkallës së parë në lidhje me rastet e dhunës në familje. Ai së pari paraqet shifrat e dhunës në familje të gjykuara nga gjykatat e shkallës së parë, duke shqyrtuar dallimet ndërmjet rajoneve në Kosovë dhe aktgjykimeve të nxjerra në ato raste. Së dyti, ai përfshin një analizë të një mostre të aktgjykimeve në lidhje me pajtueshmërinë e tyre me dispozitat teknike të përcaktuara në KPPRK, politikat ndëshkuese të zbatuara dhe masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit gjatë procedurës. Së treti, analiza ofron të dhëna mbi kërkesat për urdhra për mbrojtje kundër dhunës në familje, përmes një mostre aktgjykimesh në këtë drejtim. Në fund, ky kapitull ofron njohuri nga seancat e monitoruara gjyqësore.

### Rastet e dhunës në familje të trajtuara nga gjykatat e shkallës së parë shprehur në numra

Bazuar në të dhënat zyrtare të siguruar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) për periudhën 1 korrik 2022 - 30 prill 2023,<sup>25</sup> është e evidente se gjykatat e shkallës së parë së bashku me degët e tyre kanë pranuar gjithsej 625 raste të dhunës në familje. Në mesin e këtyre rasteve, Gjykata Themelore në Prishtinë veçohet me numrin më të madh të rasteve (258), ndërsa Gjykata Themelore në Mitrovicë ka regjistruar numrin më të vogël të rasteve të dhunës në familje gjatë periudhës raportuese.

**Grafiku 7.** Numri i rasteve të dhunës në familje të pranuar në gjykata (korrik 2022 - prill 2023)



Numri më i madh i rasteve të regjistruara në Gjykatën Themelore në Prishtinë, pasqyron më tej karakteristikën e këtij rajoni si rajoni me numrin më të madh të raporteve policore për dhunë në familje, si dhe numrin më të madh të lëndëve të trajtuara nga prokuroria. Të kundërtën nga kjo, Mitrovica regjistron numrin më të ulët të rasteve gjyqësore që lidhen me dhunën në familje, duke reflektuar statusin e saj si rajoni me më pak raportime të dhunës në familje në polici, dhe ngarkesën më të ulët me raste në nivel prokurorial.

<sup>25</sup> GLPS ka parashtruar kërkesë në KGJK për të dhënat e periudhës maj-qershor 2023, por deri në momentin e hartimit të këtij raporti nuk i kemi pranuar me arsyetimin se nevojitet kohë për të përpiluar të dhënat e kërkuara.

Për më tutje, JUST REACT ka siguruar të dhëna që kanë të bëjnë me numrin total të aktgjykimeve të nxjerra nga gjykatat, përfshirë llojet e tyre dhe dënimet rezultuese në rastet aktive gjatë periudhës së vlerësimit. Gjatë kësaj periudhe, gjykatat kanë nxjerrë gjithsej 254 aktgjykime dhe 52 vendime. Nga analiza e të dhënave rezulton se nga këto aktgjykime, gjykatat kanë shpallur fajtor të akuzuarit për dhunë në familje në 243 raste, çka nënkupton se në mbi 90% të rasteve nën kompetencën e gjykatës janë dhënë vendime fajësuese. 11 aktgjykimet e mbetura rezultuan me **lirim dhe refuzim**.

Në rastet kur janë nxjerrë aktgjykime fajësie, rëndësi e veçantë i është kushtuar natyrës së dënimeve të shqiptuara ndaj të dënuarve për dhunë në familje. Kryesisht, gjyqtarët kanë ndjekur një qasje të butë duke zgjedhur dënimet me kusht, vërejtjet gjyqësore apo gjobat. Në më pak raste, gjykatat vendosën të shqiptonin një dënim efektiv me burgim. Në më pak raste, u shqiptuan dënime efektive me burgim. Sidoqoftë, vlen të përmendet se përdorimi i dënimeve me kusht ose dënimeve relativisht të buta mund të ketë një efekt të kufizuar **parandalues ndaj dhunës në familje**.

## Gjetjet kryesore nga aktgjykimet e analizuar

Krahas ngarkesës me lëndë të Gjykatave Themelore, për të kuptuar më mirë efikasitetin e gjykatave në trajtimin e rasteve të dhunës në familje, JUST REACT ka analizuar gjithsej 129 aktgjykime për dhunën në familje, të publikuara në ueb faqet e shtatë gjykatave themelore të Republikës së Kosovës.<sup>26</sup> Në këtë kontekst, në nënkapitujt në vijim, ky raport do të analizojë efikasitetin e publikimit të aktgjykimeve brenda afatit kohor, politikën ndëshkuese/dënuese të zbatuar, si dhe zbatimin e masave për të siguruar praninë e të pandehurit në procedurë në këto aktgjykime.

### › Efikasiteti dhe përputhshmëria me dispozitat ligjore për publikimin e aktgjykimeve

Në lidhje me publikimin e aktgjykimeve, KPPRK,<sup>27</sup> si dhe Ligji për Gjykatat përcaktojnë se gjykatat janë të obliguara që të gjitha aktgjykimet t'i publikojnë online brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga nxjerrja e tyre.<sup>28</sup>

Nga gjetjet e JUST REACT, është e evidente se nga 129 aktgjykime të analizuar, 79 aktgjykime janë publikuar brenda afatit ligjor, ndërsa 49 të tjera janë publikuar pas afatit të caktuar me një rast të dukshëm, ku Gjykatës Themelore në Gjilan i janë dashur 922 ditë për të publikuar një **aktgjykim**.<sup>29</sup>

26 Aktgjykimet e analizuar janë të qasshme në: <https://www.gjyqesori-rks.org/aktgjykimet/> me numër të rastit: P.nr.264/21; P.nr.275/2021; P.nr.751/2021; P.nr.773/2021; P.nr.1061/21; P.nr.57/2022; P.nr.223/22; P.nr. 107/2022; P.nr.275/22; P.nr.170/22; P.nr.277/2022; P.nr.679/22; P.nr.540/22; P.nr.682/22; P.nr.700/2022; P.nr.914/22; P.nr.944/22; P.nr.236/2023; P.nr. 62/2022; P.nr.94/2022; P.nr. 278/2022; P.nr.289/2022; P.nr. 312/2022; 2022:134321; P.nr.15/21; P.nr.59/22; P.nr.73/22; P.nr.170/22; P.nr.200/22; P.nr.303/22; P.nr.368/22; P.nr.459/20; P.nr.641/21; P.nr. 1629/19; P.nr.1311/22; P.nr.336/20; P.nr.1888/20; P.nr.1054/2021; P.nr.1811/21; P.nr.3342/21; P.nr.3528/21; P.nr.32/22; P.nr.228/22; P.nr.289/22; P.nr.483/22; P.nr.353/22; P.nr. 393/22; P.nr. 3159/22; P.nr. 403/22; P.nr. 559/20; P.nr. 163/22; P.nr.326/21; P.nr.416/22; P.nr. 27/22; P.nr.78/22; P.nr.414/22; P.nr. 286/2021; P.nr.41/22; P.nr. 364/22; P.nr. 379/22; P.nr.861/21; P.nr.412/22; P.nr.246/22; P.nr.356/22; P.nr.36/22; P.nr. 410/22; P.nr.572/21; P.nr. 429/22; P.nr. 194/22; P.nr.318/22; P.nr.254/22; P.Nr.255/22; P.nr. 376/22; P.nr. 543/22; P.nr. 55/22; P.nr.420/22; P.nr.83/22; P.nr.433/22; P.nr.958/20; dhe P.nr. 491/22.

27 Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, neni 370 par.1,linku: <https://shorturl.at/pHKMQ>

28 Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat, neni 6 (3) 18 dhjetor 2018, linku: <https://shorturl.at/IJMN1>


29 Aktgjykimi P. nr.393/22

**Grafiku 8.** Përqindja e aktgjykimeve të publikuara brenda dhe jashtë afatit ligjor për rastet e dhunës në familje, korrik 2022 - korrik 2023



Kur analizojmë aktgjykimet e publikuara për rastet e dhunës në familje, përsëri mund të shohim shumë dallime ndërmjet rajoneve. Në Prishtinë, për shembull, Gjykata Themelore ka publikuar gjithsej 37 aktgjykime, ndonëse vetëm në 10 nga këto raste e ka bërë këtë brenda afatit ligjor. Ngjashëm, në Mitrovicë, gjykata ka publikuar 30 aktgjykime, duke respektuar afatin ligjor në 19 raste, ndërsa Gjakova i ka publikuar të gjitha 31 aktgjykimet brenda afatit ligjor. Ndryshe, Gjykatat Themelore në Pejë dhe Ferizaj duket se kanë më pak raste, Gjykata e Pejës me vetëm një aktgjykim ndërsa ajo e Ferizajit me vetëm dy sosh brenda afatit ligjor. Këto statistika ofrojnë një pasqyrë rajonale për mbizotërimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje në Kosovë, duke theksuar ngarkesat e ndryshme me raste dhe efikasitetin në fusha të ndryshme.

**Grafiku 9.** Përputhshmëria dhe mos-përputhshmëria me afatin për publikimin e aktgjykimeve korrik 2022 - qershor 2023



Në lidhje me një aspekt tjetër teknik, struktura dhe elementet thelbësore të aktgjykimeve janë të përshkruara në nenin 369 të KPPRK-së. Ky nen thekson rëndësinë e përfshirjes së të dhënave specifike në hyrje të aktgjykimit, si data e hyrjes në fuqi dhe nëse seanca që është zhvilluar ka qenë seancë e hapur apo e mbyllur. Në aktgjykimet e analizuara nga ana e JUST REACT, është konstatuar se 17 raste nuk ishin përpiluar në harmoni me KPPRK, pasi që nuk përmbanin datën e përpilimit, ndërsa në një rast nuk kishte informacione nëse gjykimi ishte i hapur apo i mbyllur për publikun.<sup>30</sup>

30 Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, neni 369 par.2, linku: <https://shorturl.at/pHKMQ>.

## › Politika e ndëshkimit/dënimit në rastet e dhunës në familje

Nga analiza e 129 aktgjykimeve të publikuara gjatë periudhës raportuese rezulton se 126 prej tyre, ose rreth 98% përfaqësojnë aktgjykime fajësuese.

Bazuar në aktgjykimet e monitoruara, JUST REACT ka konstatuar se dënimi minimal i shqiptuar ndaj shkelësve të dhunës në familje ishte 90 ditë me kusht dhe 200 euro gjobë, ndërsa dënimi maksimal ishte me burgim efektiv prej 1 vit e 4 muaj. Është e rëndësishme të theksohet se këto dënime janë dukshëm nën masën maksimale të dënimit të lejuar sipas Kodit Penal, i cili lejon dënime e gjoba duke përfshirë gjobat dhe burgimin deri në 3 vjet për veprat përkatëse. Në shumicën e rasteve gjykatat kanë nxjerrë aktgjykime fajësuese për të akuzuarit. Në dy raste, gjykatat kanë nxjerrë aktgjykime refuzuese në bazë të nenit 362 të KPPRK-së.<sup>31</sup> Krahas kësaj, vetëm një nga 129 aktgjykimet ishte aktgjykim lirues, bazuar në nenin 363 të KPPRK-së.<sup>32</sup>


Dënimi minimal i shqiptuar:  
90-ditë me kusht dhe 200 euro gjobë

Dënimi maksimal i shqiptuar:  
Burgim efektiv në kohëzgjatje prej 1 vit e 4 muajve

Dënimi i paraparë sipas Kodit Penal:  
Dënim me gjobë dhe me burgim deri në 3 vjet

### Grafiku 10.

Llojet e aktgjykimeve që ishin publikuar nga gjykatat gjatë periudhës korrik 2022-qershor 2023



31 Sipas kësaj dispozite, gjykata merr aktgjykim me të cilin refuzohet akuza, kur: prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza nga hapja deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor; 1.2. i akuzuari për të njëjtën veprë është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë; 1.3. ka kaluar afati i parashkrimit dhe vepra përfshihet në amnistia ose falje, ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që e përjashtojnë ndjekjen penale; ose 1.4. i dëmtuari tërhiqet nga propozimi për veprë penale që nuk ndjeket sipas detyrës zyrtare, përveç nëse gjykata ka prova se vendimi për t'u tërhequr është ndikuar në mënyrë të padrejtë nga pala e tretë

32 Kjo dispozitë përcakton se vepra me të cilën akuzohet i akuzuari nuk përbën veprë penale; ka rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale; apo nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën ai akuzohet.

Meqenëse shumica e gjykimeve përfaqësojnë aktgjykime fajësuese, JUST REACT u thellua për të analizuar llojin e dënimeve të shqiptuara në ato aktgjykime. Në këtë drejtim, ngjashëm me periudhat e mëparshme të monitorimit, në 65% të rasteve gjykatat më së shumti kanë shqiptuar dënime me kusht kundër shkelësve, ndërsa në vetëm 11% të rasteve janë shqiptuar dënime me burgim efektiv. Pjesa tjetër prej 24% të aktgjykimeve përfaqësojnë masa të tjera të shqiptuara kundër autorëve të dhunës në familje.

**Grafiku 11.** Dënimet për personat e akuzuar për dhunë në familje



### > Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë

Neni 171 i KPPRK-së përcakton se masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale janë: thirrja; urdhër arresti; premtimi i të pandehurit se nuk do të braktisë vendqëndrimin; ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar; paraqitja në stacionin policor; dorëzania; arresti shtëpiak; dhe paraburgimi.<sup>33</sup>

Nga aktgjykimet e analizuara, në 108 raste mungonin të dhënat nëse kryerësi ishte nën ndonjë masë për të siguruar praninë e tij në procedurë. Nga 21 rastet e tjera, masa më e shpeshtë e shqiptuar ishte paraburgimi, e cila është edhe masa më e ashpër për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale. Gjykatat e kanë shqiptuar këtë masë në 20 raste. Në rastin tjetër të mbetur është shqiptuar masa e arrestit shtëpiak.

Nga analiza e aktgjykimeve ishte evidente se kohëzgjatja maksimale e paraburgimit për rastet e dhunës në familje është 4 muaj e 13 ditë, ndërsa kohëzgjatja mesatare e masës së paraburgimit në këto raste është 2 muaj. **Gjithashtu, nga 129 aktgjykimet e analizuara, gjykata ka shqiptuar vetëm n% një rast masën e arrestit shtëpiak.**

Lidhur me kohëzgjatjen e paraburgimit, KPPRK parasheh që ai duhet të zgjatë ndërmjet 30 ditë dhe 12 muaj, përveç në rastet shumë specifike kur kjo masë mund të zgjatet deri në 18 muaj.<sup>34</sup> Nga analiza e aktgjykimeve, ishte evidente se kohëzgjatja mesatare e kësaj mase ishte 2 muaj, përderisa maksimumi 4 muaj e 13 ditë. Sidoqoftë, në tre raste<sup>35</sup> kohëzgjatja e paraburgimit ishte deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.

Gjithashtu, nga 129 aktgjykimet e analizuara, gjykata vetëm në një rast ka caktuar masën e arrestit shtëpiak.

<sup>33</sup> Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, neni 171, linku: <https://shorturl.at/imJMQ>

<sup>34</sup> Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, neni 187, i disponueshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759>


<sup>35</sup> P.nr. 32/22, P.nr.416/22, P.nr.700/22,

## Urdhrat për mbrojtje kundrejt kërkesave kundër dhunës në familje

Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, ndër të tjera, rregullon procesin e lëshimit të urdhrave civile për mbrojtje për viktimat e dhunës në familje.<sup>36</sup> Sipas LMDhF, viktimat kanë të drejtë të parashtrojnë një kërkesë për urdhër mbrojtje, e cila ka për qëllim t'i mbrojë ato/ata nga vazhdimi i dhunës. Këto urdhra mbrojtjeje kategorizohen në tri lloje të dallueshme, ku secili lidhet me institucionin dhe procedurat për lëshimin e tyre. Së pari, “Urdhri për Mbrojtje” lëshohet me vendim të gjykatës dhe përfshin një varg masash mbrojtëse të krijuara për t'i ofruar mbrojtje viktimës. Së dyti, “Urdhri për Mbrojtje Emergjente” është një urdhër i përkohshëm i lëshuar nga gjykata për të ofruar mbrojtje të menjëhershme. Së treti, “Urdhri për Mbrojtjen e Përkohshme Emergjente” lëshohet zakonisht nga policia, kur kërkesa vjen jashtë orarit të punës së gjykatës. Qëllimi parësor i këtyre urdhrave është që të krijojë një pengesë ligjore ndërmjet autorit dhe viktimës, dhe shkelja e urdhrit përbën vepër penale të veçantë.


JUST REACT ka analizuar 72 kërkesa për Urdhër Mbrojtjeje, gjatë periudhës së monitorimit. Nga 72 kërkesa, 48 prej tyre janë miratuar, gjashtë janë refuzuar, pesë janë miratuar pjesërisht, ndërsa në 13 raste **kërkesa është tërhequr nga viktimat**.

**Grafiku 12.** Miratimi i Urdhrave për Mbrojtje nga gjykatat



Nga 72 kërkesa, 55 (apo 76%) e parashtruesve ishin gra të cilat kërkonin mbrojtje, ndërsa 13 (apo 18%) ishin burra. Në katër raste nuk kishte të dhëna të mjaftueshme lidhur me identitetin gjinor të individëve të përfshirë. Këto të dhëna përsëri nënvizojnë mbizotërimin e grave të cilat kërkojnë urdhra për mbrojtje si viktimat e dhunës në familje.

**Grafiku 13.** Identiteti Gjinor i Parashtruesve të kërkesave për Urdhra për Mbrojtje që ishin analizuar




36 LIGJI Nr. 03/L-182 PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE, linku: <https://shorturl.at/cpUZ1>

## Të dhënat nga monitorimi i seancave gjyqësore

Përveç monitorimit të aktgjykimeve, nga korriku i vitit 2022, JUST REACT sistematikisht po monitoron edhe seancat gjyqësore për rastet e dhunës në familje.<sup>37</sup>

Grafiku 14. Statistikat e monitorimit



Nga ky monitorim për periudhën raportuese, JUST REACT ka identifikuar një sërë gjetjesh, të renditura më poshtë:

1. Rastet e dhunës në familje trajtohen si lëndë me prioritet të lartë nga gjykatat dhe **prokurorët**;
2. Gjyqtarët respektojnë detyrimin për të zhvilluar seancat pa praninë e **publikut**;
3. Në të gjitha seancat për urdhrat mbrojtjeje shqiptohet një nga urdhrat e LMDhF-së;
4. Nuk ekziston mekanizmi i mbikëqyrjes së personave kundër të cilëve **është lëshuar** urdhri mbrojtës;
5. Nga numri i përgjithshëm i seancave të monitoruara, 385 ose 32% e tyre nuk janë **mbajtur**;
6. Arsyet më të shpeshta për mos mbajtjen e seancave ishin mungesa e të akuzuarit (në më shumë se 60% të rasteve), mungesa e prokurorit apo gjyqtarit, mungesa e palës së dëmtuar, mungesa e përfaqësuesve ligjorë, ndër të tjera;
7. Gjykatat vazhdojnë të shqiptojnë dënime me kusht në lidhje me kryerësit e dhunës në familje, edhe në rastet kur këto dënime janë efektive, ato janë larg dënimit maksimal të paraparë për këtë vepër penale;

Përveç monitorimit të seancave gjyqësore, përmes projektit JUST REACT, GLPS ka monitoruar edhe mbledhjet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës, Komisionit për Legjislacion dhe Komisionit për të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Kosovës. Për më tej, GLPS ka përpiluar çdo ditë raporte gazetareske lidhur me seancat e monitoruara. Këto raporte gazetareske së bashku me të dhënat nga raportet 24 orëshe të Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë së Shtetit janë publikuar në platformën “Drejtësia Sot” [Justice Today].<sup>38</sup>

37 Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet KGJK-së dhe GLPS-së, 2022, linku: <https://shorturl.at/nPR45>

38 Platforma “Drejtësia Sot”, linku: <https://drejtetasot.com/>

## Gjetjet dhe rekomandimet

Gjetjet kryesore që kanë rezultuar nga kjo analizë janë:

1. Gjatë periudhës së vlerësimit (korrik 2022 - qershor 2023), janë raportuar gjithsej 2735 raste të dhunës në familje në nivel vendi.
2. Prishtina prinë me numrin e rasteve të raportuara, me 910 raste, e ndjekur nga Peja, Prizreni, Gjlani, Ferizaj dhe Gjakova.
3. Analiza e përshtatur sipas popullsisë zbuloi se Peja kishte numrin më të madh të rasteve të raportuara të dhunës në familje për 10,000 banorë, e ndjekur nga **Prishtina**.
4. Gratë janë të prekura në mënyrë disproporcionale nga dhuna në familje, ku 79% e viktimave janë gra, sipas raporteve të policisë.
5. Në shumicën e rasteve dhuna ka ndodhur brenda marrëdhënieve bashkëshortore.
6. Vihet re një tendencë pozitive për sa i përket rritjes së numrit të të arrestuarve për dhunë në familje krahasuar me periudhën e mëparshme të monitorimit.
7. Prokurorët ndonjëherë ndryshojnë për nga mënyra se si ata e cilësojnë dhe arsyetojnë dhunën në familje si vepër penale, gjë që mund të çojë në probleme gjatë përcaktimit të dënimeve nga ana e gjykatave. Përveç kësaj, ka vend për përmirësime në aspektin e arsyetimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese në aktakuza.
8. Gjykata Themelore në Prishtinë kishte numrin më të madh të rasteve të dhunës në familje, ndërsa Gjykata Themelore në Mitrovicë kishte numrin më të vogël.
9. Gjykatat e shpallën fajtor të akuzuarin në mbi 90% të rasteve. Sidoqoftë, në aktgjykimet e publikuara, lloji më i zakonshëm i dënimit të shqiptuar ishte dënimi me kusht, dhe dënimi me burgim efektiv ishte përdorur më rrallë.
10. Bazuar në aktgjykimet e analizuara lidhur me urdhrat për mbrojtje një pjesë e konsiderueshme e tyre janë miratuar. Përsëri, gratë përbëjnë më shumë se 76% të kërkesave për urdhër për mbrojtje nga dhuna në familje.
11. Zbatimi efektiv i urdhrave për mbrojtje përbëhet nga shumë sfida, të cilat theksojnë nevojën e mbikëqyrjes elektronike për **avancimin** e zbatimit të tyre.
12. Në seancat e monitoruara gjyqësore, është vënë re se lëndët e dhunës në familje trajtohen si prioritet i lartë nga gjykatat dhe prokuroritë.

Nga këto gjetje, JUST REACT jep këto rekomandime për institucionet të cilat merren me **rastet e dhunës në familje**:

1. Rritja e efikasitetit të Policisë së Kosovës në parandalimin dhe hetimin e rasteve të dhunës në familje dhe kapjen e të dyshuarve për këtë **vepër**;
2. Prokurori i Shtetit duhet të cilësojë saktë veprat e dhunës në familje në përputhje me Udhëzimin e Gjykatës Supreme;
3. Prokurori i Shtetit duhet të sigurojë që aktakuzat e ngritura të jenë gjithëpërfshirëse dhe të përfshijnë prova të arsyetuara të cilat vërtetojnë fajësinë e **të akuzuarit**;



4. Gjykatat duhet të vazhdojnë t'i trajtojnë këto lëndë me prioritet dhe të japin arsytetime të hollësishme për vendimet e tyre;
5. Qeveria e Kosovës/Ministria e Punëve të Brendshme duhet të fillojë urgjentisht procedurat e blerjes së teknologjisë për mbikëqyrjen e zbatimit të urdhrave për mbrojtje;
6. Rekomandohet që gjykatat të zbatojnë në mënyrë rigoroze Udhëzuesin e Gjykatës Supreme për Politikën Ndëshkimore;
7. Rekomandohet që gjykatat të shqiptojnë dënime adekuate në bazë të provave në mënyrë që të arrihet qëllimi i dënimit.

\* Ky publikim është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përbajtja e tij është përgjegjësi ekskluzive e Grupit për Studime Ligjore dhe Politike (GLPS) dhe Fondit për Zhvillimin e Komunitetit (CDF) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e **Bashkimit Evropian.**'

# Trajtimi institucional i rasteve të dhunës në familje

KORRIK 2022 - QRSHOR 2023



Grupi për Studime  
Juridike dhe  
Politike

